

ABSTRAKTI

Gjykata administrative është një lloj gjykate e specializuar për të drejtën administrative, veçanërisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me ushtrimin dhe akteve të pushtetit publik. Roli i Gjykatave Administrative është të konstatojnë se aktet zyrtare janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në territorin e Republikës së Kosovës. Gjykatat e tilla konsiderohen të ndara nga gjykatat e zakonshme. Gjatë hulumtimit tonë empirik kemi hasur në numër relativisht të vogël të kërkimeve shkencore, që kanë trajtuar garancitë adekuate që e mbrojnë gjyqësinë administrative nga presionet e jashtme. Duke u thirrur në këtë dhe me zhvillimet e mëdha që po pëson bota dhe rëndësia e gjyqësisë administrative në njërën anë dhe kërkesat e shtuara për të zgjidhur konfliktet ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve shtetërore/publike është caku apo qëllimi i këtij punimi. Në mënyrë që të arrihen objektivat e punimit, zgjedhja e metodologjisë së duhur është po aq e rëndësishme sa edhe vet punimi. Qasja metodologjike duhet të bazohet mbi tematikën e hulumtuar dhe mënyrës se si do t'i qaset asaj që në rastin tonë ka qenë qasja cilësore apo kualitative dhe është bërë përmes rishikimit të literaturës, botimeve, punimeve shkencore, ligjeve, konventave dhe rregulloreve të Kushtetutave përkatëse. Garancitë e pavarësisë së jashtme të gjyqësisë administrative kanë qenë objekt i rekomandimeve, opinioneve dhe direktivave të shumta. Standardet konkrete dhe të detajuara janë propozuar ose miratuar në nivel evropian. Është jetike që çdo gjyqtar i cili gjykon çështje me kontekst administrativ të jetë në gjendje të vendosë çështjet vetëm mbi provat e paraqitura në gjykatë nga palët dhe në përputhje me ligjin. Vetëm faktet relevante dhe ligji duhet të përbëjnë bazën e vendimit të çdo gjyqtari. Kjo posaçërisht vlen për kontestet administrative, ku këto garanci janë më së të nevojshme kur kemi të bëjmë me çështje publike – shtetërore dhe ku ndikimi i jashtëm mund të sjellë një vendim joadekuat i cili do të ketë pasoja dhe dëm kolektiv afatgjatë.

Fjalët kyçe: juridiku, gjykata, administrative, gjyqësori, garancitë, ndikimi i jashtëm.

ABSTRAKTINË ANGLISHT

The administrative court is a type of court specialized in administrative law, especially in resolving disputes related to the exercise and acts of public acts. The role of the Administrative Courts is to ascertain that the official acts are in accordance with the Constitution and applicable laws in the territory of the Republic of Kosovo. Such courts are considered separate from ordinary courts. During our empirical research, we have come across a relatively small number of scientific researches that have dealt with the adequate guarantees that protect the administrative judiciary from external pressures. Referring to this, with the great developments that the world is undergoing and the importance of administrative justice on the one hand and the increased requirements to resolve conflicts between citizens and state/public institutions, is the goal of this paper. In order to achieve the objectives of the paper, choosing the right methodology is as important as the paper itself. The methodological approach should be based on the researched topic and how it will be approached, which in our case was the qualitative approach and was done through the review of literature, publications, scientific works and laws, conventions, regulations, The respective constitutions. The guarantees of the external independence of the administrative judiciary have been the subject of numerous recommendations, opinions and directives. The guarantees of the external independence of the administrative judiciary have been the subject of numerous recommendations, opinions and directives. Concrete and detailed standards have been proposed or approved at the European level. It is vital that any judge who hears cases with an administrative context should be able to decide cases based solely on the evidence presented to the court by the parties and in accordance with the law. Only the relevant facts and the law should form the basis of any judge's decision. This especially applies to administrative disputes, where these guarantees are most necessary, when we are dealing with public-state issues and where external influence may bring an inadequate decision which will have long-term collective consequences and damage.

Key words: legal, court, administrative, judiciary, guarantees, external influence

